



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.1329/7prot.

Datë 20.06.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 715/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.06.2024 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Besim Kamberi” P.F, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-02880-04-29-2024, me objekt: “Blerje materiale pastrimi për Institucionet Arsimore, Bashkia Berat”, me fond limit 2,249,474.00 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 10.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Berat.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “4 S” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Besim Kamberi” P.F. me NIPT L42103023G dhe adresë: Rruga e Qelqit, Zona Kadastrale Nr. 3866, Nr. Pasurie 310/20 - Kashar, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Berat  
Rruga “Antipatrea”.

**Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “4 S” SHPK me NIPT L64425401K dhe adresë: Lagjja “Xhevdet Nepravishta”, Rruga “Qerim Arapi”, Zona Kadastrale 8571, Godina 196, Pasuria nr.23/104-N4, Lushnjë.

Operatori ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK me NIPT K22218003V dhe adresë: Autostrada Tiranë - Durrës, Km. 10, Rruga dytësore Vorë – Albania.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 30.04.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-02880-04-29-2024, me objekt: “Blerje materiale pastrimi për Institucionet Arsimore, Bashkia Berat”, me fond limit 2,249,474.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 10.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Berat.

II.2. Në datën 10.05.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 15.05.2024, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

4 S SHPK	1 687 105, 5 lekë	Kualifikuar
ATLANTIK 3 SHPK	1 837 000 lekë	Kualifikuar
Besim Kamberi PF	1 845 200 lekë	Kualifikuar
Malvina Visoka PF	nuk ka paraqitur oferte	Skualifikuar

II.4. Në datën 22.05.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.5. Në datën 28.05.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik 2024/4124 dhe me nr. protokolli 1329/2024, datë 28.05.2024, e operatorit ekonomik “Besim Kamberi” PF, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të

Vlerësimi të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “4 S” SHPK dhe operatori ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1329/2 datë 29.05.2024.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga operatori ekonomik “4 S” SHPK dhe operatori ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK., në cilësinë e subjektit të interesuar, në përputhje me nenin 113 të LPP-së.

II.8. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datën 03.06.2024, vendimin në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Besim Kamberi” PF, protokolluar me nr.1329/3 prot. Të njëjtin informacion autoriteti kontraktor e ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik edhe nëpërmjet shërbimit postar me shkresën nr.359/3prot., datë 03.06.2024, protokolluar me tonën me nr.1329/4prot., datë 05.06.2024.

II.9. Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Besim Kamberi” PF dhe ka njoftuar operatorët ekonomikë “4 S” SHPK dhe “ATLANTIK 3” SHPK se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, duke pranuar pretendimet si më poshtë:

*[...] Për sa i takon - Lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik 4 S*

*...Për sa i takon arsyes 2. Pika e DST 2.3.5. Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin: Magazine për mbajtjen e materialeve dhe produktet e pastrimit të pastrimit në pronësi/me qera ose në përdorim sipas kontratës noteriale, kur ambjenti eshte ne pronesi duhet te jete I pajisur me :*

*- Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri te vlefshme ne kohen e zhvillimit te procedures. – Akt-miratim higjeno sanitar - Çertifikatën e dezinfektimit 3D - Si dhe foto të ambjenteve të ushtrimit të aktivitetit. Ne rastin se nuk kane magazine ne pronesi ose me qira ose perdorim duhe te paraqesin nje kontrate furnizimi per produktet object prokurimi.*

*Duke parë ekstraktin e kësaj shoqërie evidentojmë këto adresa të ushtrimit të aktivitetit të cilat mund të shërbejnë si magazinim duke hequr automjetet: - Lagjja Xhevdet Nepravishta, Rruga Qerim Arapi, Zona Kadastrale 8571, Godina 196, Pasuria nr.23/104-N4 - Tirane Kashar YZBERISH Lagjja Yzberish, Unaza e Re, Rruga Aleksandri i Madh, Pallati Lorena shpk, Zona*

Kadastrale 3866, Pasuria Nr. 301/209-N13 - Tirane Kashar YZBERISH Unaza e Re, Lagjja Yzberish, rruga "Foto Xhavella", pallati Omars 2000, godina nr 1, kati 1

*Për kë nga këto adresa operatori ekonomik 4 S ka dorëzuar dokumentacion?*

*Per sa i perket ketij pretendimi sqarojme se nga verifikimi rezulton se ky operator ka paraqitur dokumentacionin provues per ambientin ne pronesi (certificate pronesie) me adrese Lagjja Xhevdet Nepravishita, Rruga Qerim Arapi, Zona Kadastrale 8571, Godina 196, Pasuria nr.23/104-N4 sipas kerkesave ne piken 2.3.5 te DST-ve. Nga shqyrtimi rezulton se kemi te bejme me magazine ushqimore, te specifikuar edhe ne aktin higjieno sanitar por edhe ne certifikaten per mbrojtjen nga zjarri. Kjo bie ndesh me kerkesat e percaktuara ne DST duke mos plotesuar kushtet e magazinimit sipas legjislacionit ne fuqi.*

***Për sa më sipër ky pretendim i ankuesit qëndron.***

...

*Acid wc Ilit/bidoni. Acid përpastrim WC, të ketë aftësi vepruese dhe pastruese të larta. Ambalazhimi në shishe plastike. Të përmbajë HCL jo më pak se 30%. Gjëndja fizike e lëngut të jetë lëng i pastër, i bardhë .Të jetë i tretshëm në ujë Operatori ekonomik 4 S ka dorëzuar acid extra forte marka "SCRAC 1" liter por nuk përmbush specifikimet teknike sipas autoritetit kontraktor i cilin kërkon të përmbajë HCL jo më pak se 30% acid klorhidrik dhe mostra e dorëzuar nga operatori ekonomik 4 S përmban jo më shumë se 25 % të shënuar në etiket bidon i bardhë me tap të zezë. Gjithashtu nuk plotëson afatin e skadencës e cila është 2025. Pa ditë dhe muaj të vitit 2025. Pra produkti skadon më datë 01.01.2025*

*Në lidhje me pretendimin e ankuesit per zerin me siper dhe specifikimeve teknike te percaktuara ne DST rezulton se Acid wc Ilit/bidoni permban rreth 50% acid klorhidrik. Ne lidhje me daten e skadences se produktit te ofertuar rezulton se ky produkt nuk ka date skadence ne bidon. Per kete arsye konstatimet e parashtruara ne ankese qendrojne pjeserisht.*

***Për sa më sipër pretendimi i operatorit ankimues qëndron pjesërisht***

*Per sa i takon arsyet 4. Lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik ATLANTIK 3, AK ka zgjedhur që të kualifikojë një subjekt i cili nuk përmbush specifikimet teknike të produkteve. Më poshtë po argumentojmë mospërputhjen e specifikimeve teknike me mostrat e dorëzuara nga ky operator ekonomik. Autoriteti Kontraktor kërkon produktin Sfungjer me tel larje enësh. Sfungjer për larjen e enëve me dorë, sipërfaqe me material gërryes për të hequr njollat e vështira dhe në pjesën e brendëshme material sfungjer. Përmasat e sfungjerit të jenë minimumi 13 cm x 9 cm. Sipas specifikimeve teknike kërkohet sfungjer pjesa e brendshme e veshur me tel pjesa e jashtme permasa 13\*9 cm. Operatori ekonomik ATLANTIK 3 ka dorëzuar një pako sfungjer i thjeshtë me abraziv ngjyrë jeshile pjesa e sipërme dhe 1 pako tele enësh, pako ngjyre portokalli. Ndërkohë modeli i sfungjerit me veshje teli që kërkon autoriteti kontraktor është model krejt*

*ndryshe nga ajo cka ofruar operatori ekonomik. Pasi të dy elementët përbërës duhe të jenë në një produkt të vetëm dhe jo ne dy produkte të ndryshme. Bashkëlidhur ankesës sonë po ju paraqesim dhe foto të mostrave të dorëzuar nga ky operator ekonomik, ku dallohet qartë mospërputhja e tyre.*

*Ne lidhje me pretendimin e ankuesit per zerin me siper dhe specifikimeve teknike te percaktuara ne DST, konstatimet e parashtruara ne ankese qendrojne pasi sfungjeri me tel per larje enesh nuk ka material te veshur me tel sic kerkohet.*

***Për sa më siper pretendimi i operatorit ankimues qëndron***

*- Fshirse xhamash+ bisht . Paisje me gomë dhe sfungjer për larjen e xhamave me bisht zgjatues metalik. Sfungjeri të jetë i plotë dhe me material të butë për fërkimin e xhamit, pa e dëmtuar atë dhe goma të jetë elastike për pastrimin e shkumës apo solucionit në xham. Autoritet Kontraktor ka kërkuar fshirse xhamash +bisht. Sipas specifikimeve teknike është kërkuar me bisht zgjatues për arsye sepse mund të ketë xhama të lartë dhe duhet patjetër bisht zgjatues i cili shkon më shumë se 130 cm që është një bisht normal fshese apo shtupe. Ndërkohë operatori ekonomik ATLANTIK 3 ka dorëzuar fshirse xhamash me bisht por bishti i cili ai ka dorëzuar është metalik ngjyre i kuqërrem me vija me kapuc të zi dhe me gjatësi 130 cm, i cili nuk është zgjatues por bisht normal fshese ose shtupe.*

*Ne lidhje me pretendimin e ankuesit per zerin me siper dhe specifikimeve teknike te percaktuara ne DST, konstatimet e parashtruara ne ankese qendrojne pasi bisht nuk eshte zgjatues sic kerkohet.*

***Për sa më siper pretendimi i operatorit ankimues qëndron.***

*- Aromatizues rrobash 3 liter/bidoni. Detergjent për aromatizues të jetë i lëngshëm, të shërbej për zbutjen e rrobave dhe aromatizimin e tyre, të jetë me aromë luleje, të zvogëlojë kohën e tharjes, si dhe të ndihmojë për të pastruar dhe zvogëluar rrudhosjen e rrobave, të parandalojë zbehjen e ngjyrave. Ndërkohë produkti i dorëzuar nga operatori ekonomik ATLANTIK 3 është marka “soft” bidon ngjyrë bojqielli me tap ngjyrë gold në të kaftë, i cili nuk ka datë prodhimi dhe datë skadimi. Ai ka vetëm një kod prodhimi loti. Në rast se produkti është pa datë skadimi ose prodhimi duhet të shënohet në etiket ose operatori duhet të paraqesi një deklaratë nga firma prodhuese ose distributori i autorizuar për pjesën e datës së skadimit të produktit.*

*Në lidhje me pretendimin e ankuesit për zërin me siper dhe specifikimeve teknike të percaktuara ne DST, konstatimet e parashtruara në ankesë qëndrojnë pasi produkti i paraqitur nuk përmban datë prodhimi dhe datë skadimi.*

***Për sa më siper pretendimi i operatorit ankimues qëndron.***

#### **IV. Konkluzioni:**

##### **Sa më sipër komisioni vendos:**

1. Pranimin pjëserisht të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Besim Kamberi”.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Besim Kamberi” P.F, për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “4 S” SHPK dhe “ATLANTIK 3” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datën 03.06.2024, vendimin në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Besim Kamberi” PF, protokolluar me nr. 1329/3 prot. Të njëjtin informacion autoriteti kontraktor e ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik edhe nëpërmjet shërbimit postar me shkresën nr.359/3prot., datë 03.06.2024, protokolluar me tonën me nr.1329/4prot., datë 05.06.2024.

II.9. Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Besim Kamberi” PF dhe ka njoftuar operatorët ekonomikë “4 S” SHPK dhe “ATLANTIK 3” SHPK, se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, duke pranuar pretendimet si më poshtë:

[...]Lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik 4 S

*...Për sa i takon arsyet 2. Pika e DST 2.3.5. Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin: Magazine për mbajtjen e materialeve dhe produktet e pastrimit të pastrimit në pronësi/me qera ose në përdorim sipas kontratës noteriale, kur ambjenti është në pronësi duhet të jete I pajisur me :*

*- Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës. – Aktmiratim higjeno sanitar - Çertifikatën e dezinfektimit 3D - Si dhe foto të ambjenteve të ushtrimit*

të aktivitetit. Ne rastin se nuk kane magazine ne pronesi ose me qira ose perdorim duhe te paraqesin nje kontrate furnizimi per produktet object prokurimi.

Duke parë ekstraktin e kësaj shoqërie evidentojmë këto adresa të ushtrimit të aktivitetit të cilat mund të shërbejnë si magazinim duke hequr automjetet: - Lagjja Xhevdet Nepravishta, Rruga Qerim Arapi, Zona Kadastrale 8571, Godina 196, Pasuria nr.23/104-N4 - Tirane Kashar YZBERISH Lagjja Yzberish, Unaza e Re, Rruga Aleksandri i Madh, Pallati Lorena shpk, Zona Kadastrale 3866, Pasuria Nr. 301/209-N13 - Tirane Kashar YZBERISH Unaza e Re, Lagjja Yzberish, rruga "Foto Xhavella", pallati Omars 2000, godina nr 1, kati 1

*Për kë nga këto adresa operatori ekonomik 4 S ka dorëzuar dokumentacion?*

Persa i perket ketij pretendimi sqarojme se nga verifikimi rezulton se ky operator ka paraqitur dokumentacionin provues per ambientin ne pronesi (certificate pronesie) me adrese Lagjja Xhevdet Nepravishta, Rruga Qerim Arapi, Zona Kadastrale 8571, Godina 196, Pasuria nr.23/104-N4 sipas kerkesave ne piken 2.3.5 te DST-ve. Nga shqyrtimi rezulton se kemi te bejme me magazine ushqimore, te specifikuar edhe ne aktin higjeno sanitar por edhe ne certifikaten per mbrojtjen nga zjarri. Kjo bie ndesh me kerkesat e percaktuara ne DST duke mos plotesuar kushtet e magazinimit sipas legjislacionit ne fuqi.

***Për sa më sipër ky pretendim i ankuesit qëndron.***

...

Acid wc Ilit/bidoni. Acid përpastrim WC, të ketë aftësi vepruese dhe pastruese të larta. Ambalazhimi në shishe plastike. Të përmbajë HCL jo më pak se 30%. Gjendja fizike e lëngut të jetë lëng i pastër, i bardhë. Të jetë i tretshëm në ujë Operatori ekonomik 4 S ka dorëzuar acid extra forte marka "SCRAC 1" liter por nuk përmbush specifikimet teknike sipas autoritetit kontraktor i cilin kërkon të përmbajë HCL jo më pak se 30% acid klorhidrik dhe mostra e dorëzuar nga operatori ekonomik 4 S përmban jo më shumë se 25 % të shënuar në etiketë bidon i bardhë me tap të zezë. Gjithashtu, nuk plotëson afatin e skadencës e cila është 2025. Pa ditë dhe muaj të vitit 2025. Pra produkti skadon, më datë 01.01.2025.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit per zerin me siper dhe specifikimeve teknike te percaktuara ne DST rezulton se Acid wc Ilit/bidoni permban rreth 50% acid klorhidrik. Ne lidhje me daten e skadences se produktit te ofertuar rezulton se ky produkt nuk ka date skadence ne bidon. Per kete arsye konstatimet e parashtruara ne ankese qendrojne pjeserisht.

***Për sa më sipër pretendimi i operatorit ankimues qëndron pjesërisht***

Lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik ATLANTIK 3, AK ka zgjedhur që të kualifikojë një subjekt i cili nuk përmbush specifikimet teknike të produkteve. Më poshtë po argumentojmë mospërputhjen e specifikimeve teknike me mostrat e dorëzuara nga ky operator ekonomik. Autoriteti Kontraktor kërkon produktin Sfungjer me tel larje enësh. Sfungjer për larjen e enëve



me dorë, sipërfaqe me material gërryes për të hequr njollat e vështira dhe në pjesën e brendshme material sfungjer. Përmasat e sfungjerit të jenë minimumi 13 cm x 9 cm. Sipas specifikimeve teknike kërkohet sfungjer pjesa e brendshme e veshur me tel pjesa e jashtme permasa 13\*9 cm. Operatori ekonomik ATLANTIK 3 ka dorëzuar një pako sfungjer i thjeshtë me abraziv ngjyrë jeshile pjesa e sipërme dhe 1 pako tele enësh, pako ngjyre portokalli. Ndërkohë modeli i sfungjerit me veshje teli që kërkon autoriteti kontraktor është model krejt ndryshe nga ajo cka ofruar operatori ekonomik. Pasi të dy elementët përbërës duhe të jenë në një produkt të vetëm dhe jo në dy produkte të ndryshme. Bashkëlidhur ankesës sonë po ju paraqesim dhe foto të mostrave të dorëzuar nga ky operator ekonomik, ku dallohet qartë mospërputhja e tyre.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për zërin me sipër dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në DST, konstatimet e parashtruara në ankesë qendrojnë pasi sfungjeri me tel për larje enësh nuk ka material të veshur me tel sic kërkohet.

#### ***Për sa më sipër pretendimi i operatorit ankimes qëndron***

- Fshirje xhamash+ bisht . Paisje me gomë dhe sfungjer për larjen e xhamave me bisht zgjatues metalik. Sfungjeri të jetë i plotë dhe me material të butë për fërkimin e xhamit, pa e dëmtuar atë dhe goma të jetë elastike për pastrimin e shkumës apo solucionit në xham. Autoritet Kontraktor ka kërkuar fshirje xhamash +bisht. Sipas specifikimeve teknike është kërkuar me bisht zgjatues për arsye sepse mund të ketë xhama të lartë dhe duhet patjetër bisht zgjatues i cili shkon më shumë se 130 cm që është një bisht normal fshese apo shtupe. Ndërkohë operatori ekonomik ATLANTIK 3 ka dorëzuar fshirje xhamash me bisht por bishti i cili ai ka dorëzuar është metalik ngjyre i kuqërrem me vija me kapuc të zi dhe me gjatësi 130 cm, i cili nuk është zgjatues por bisht normal fshese ose shtupe.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për zërin më sipër dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në DST, konstatimet e parashtruara në ankesë qendrojnë pasi bisht nuk është zgjatues sic kërkohet.

#### ***Për sa më sipër pretendimi i operatorit ankimes qëndron.***

- Aromatizues rrobash 3 liter/bidoni. Detergjent për aromatizues të jetë i lëngshëm, të shërbej për zbutjen e rrobave dhe aromatizimin e tyre, të jetë me aromë luleje, të zvogëlojë kohën e tharjes, si dhe të ndihmojë për të pastruar dhe zvogëluar rrudhosjen e rrobave, të parandalojë zbehjen e ngjyrave. Ndërkohë produkti i dorëzuar nga operatori ekonomik ATLANTIK 3 është marka “soft” bidon ngjyrë bojqielli me tap ngjyrë gold në të kaftë, i cili nuk ka datë prodhimi dhe datë skadimi. Ai ka vetëm një kod prodhimi loti. Në rast se produkti është pa datë skadimi ose prodhimi duhet të shënohet në etiket ose operatori duhet të paraqesi një deklaratë nga firma prodhuese ose distributori i autorizuar për pjesën e datës së skadimit të produktit.

*Në lidhje me pretendimin e ankuesit për zërin me sipër dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në DST, konstatimet e parashtruara në ankesë qëndrojnë pasi produkti i paraqitur nuk përmban datë prodhimi dhe datë skadimi.*

***Për sa më sipër pretendimi i operatorit ankimes qëndron.***

#### **IV. Konkluzioni:**

***Sa më sipër komisioni vendos:***

1. *Pranimin pjesërisht të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Besim Kamberi”.*

III.1.3. Neni 30 i LPP-së, parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se : *“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*

*ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*

2. *Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të*

*nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.*

III.1.5. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga operatori ekonomik “4 S” SHPK dhe operatori ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK., në cilësinë e subjektit të interesuar, në përputhje me nenin 113 të LPP-së.

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 1329 prot., datë 28.05.2024, të operatorit ekonomik “Besim Kamberi”P.F.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Besim Kamberi” P.F mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “4 S” SHPK dhe operatorit ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar gjyqimit më sipër në pikën III.1., vlerëson, se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative, pasi gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “4 S” SHPK dhe operatorit ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK, do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Besim Kamberi” P.F, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-02880-04-29-2024, me objekt: “Blerje materiale pastrimi për Institucionet Arsimore, Bashkia Berat”, me fond limit 2,249,474.00 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 10.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Berat.
2. Autoriteti kontraktor të bëjë rivlerësim të procedurës së prokurimit, në zbatim të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës.

3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit të KSHA -së, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Besim Kamberi”P.F.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

